

Në bazë të nenit 12.1. të Ligjit për vetëqeverisjen lokale me nr.03/L-040 , nenit 32.2. të Statutit të komunës të Dragashit dhe nenit 29. të Ligjit për vula në Institucionet e Republikës të Kosovës me Nr . 03/L-054 , Kuvendi komunal në Dragash në mbledhjen e vet te rregullt të mbajtur më datën 29.05.2009 shqyrton dhe miraton , këtë :

**RREGULLORE
PËR FORMËN , PËRMBAJTJEN , PËRDORIMIN DHE RUAJTJEN E VULAVE
TË KOMUNËS TË DRAGASHIT**

DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

**Neni 1.
Qëllimi**

Me këtë Rregullore rregullohet përdorimi , forma dhe përmbajtja ,ruajtja , ndryshimi, asgjësimi dhe çështjet tjera e vulave të Komunës të Dragashit .

Neni 2.

Komuna e Dragashit për vërtetësinë e të gjitha akteve zyrtare të veta , përdor vulën e rumbullaket dhe vulën katrore të pranimit dhe të dërgimit.

Neni 3.

3.1. Vulat e komunës të Dragashit duhet të kenë përmbajtje identike në gjuhen shqipe, serbe dhe boshnjake.

3.2. Ministria kompetente për administratë publike lejon pajisjen me vulë në bazë të kërkesës të komunës të Dragashit.

Neni 4.

4.1. Komuna e Dragashit duhet të ketë vetëm një vulë e në raste të veçanta mund të ketë dy e ma shumë vula.

4.2. Nëse komuna posedon ma shumë se 1. vulë ,ahere secili ekzemplar shënohet me numrin rendor romak i cili vihet në mesë të stemës së Kosovës dhe emërimit të selisë së institucionit.

PËRDORIMI I VULAVE

Neni 5.

5.1. Vula përdoret për vërtetimin e aktit autentik zyrtar , të cilin e lëshojnë organet e administratës komunale.

5.2. Me vulë mund të vërtetohen vetëm aktet të nënshkruara nga personat e autorizuar.

5.3. Vula vihet në anën e majtë të nënshkrimit të personit të autorizuar për nënshkrim e cila e mbulon një të katërtën e nënshkrimit.

FORMA E VULAVE DHE PËMBAJTJA

Neni 6.

6.1. Vula ka formën rrethore .

6.2. Vula ka madhësinë me diametër prej 40 mm, 50 mm dhe 60 mm.

6.3. Varësisht nga gjatësia e tekstit dhe numrit të gjuhëve të cilat shkruhen në vulë , caktohet madhësia e vulës.

Neni 7.

7.1. Vula e komunës ka shumë rrethë koncentrik në të cilët shënohen:

- në rrethin e parë të jashtëm shkruhet - Republika e Kosovës
- në rrethët e tjerë shkruhet emërtimi i institucionit dhe selia e tij
- në sipërfaqen e mbetur të vulës vendoset stema e Republikës të Kosovës.

7.2 . Komuna përdor vulën e vet me stemën komunale në ato aktet për të cilat nuk janë të obliguara të vendosin stemën e Kosovës , sipas dispozitave të Ligjit për përdorimin e Simboleve Shtetërore të Kosovës.

7.3. Vulat e komunale duhet të jen në pajtim me dispozitat e kiti Ligji , përjashtimisht përdorimi i stemës së tyre sipas nenit 7.2 të kësaj Rregullore

Neni 8.

Teksti i vulës komunale shkruhet me shkronja të mëdha të shtypit në madhësi dhe formë të njëjtë në gjuhët zyrtare të komunave.

Neni 9.

9.1. Komuna posedon edhe vulën katrore me të cilën protokollohej shkresat zyrtare.

9.2. Vula katrore ka dimensionin 35mm me 70mm po mund të lejohen edhe dimensione tjera sipas nevojës

Neni 10.

Vula katrore përmban këto të dhëna:

- Stemën e Republikës të Kosovës
- Republika e Kosovës,
- Emrin e komunës me shkronja të shtypit ,
- Numrin e protokollit të njësisë organizative
- Numrin e protokollit të shkresës
- Numri i shtojcave zyrtare të bashkangjitura
- Dita , muaji dhe viti
- Selia e komunës – institucionit.

Neni 11.

Për marrjen e lejes për vulë , porositjen e saj , arkivimin e vulës , shpalljen e pavlefshme të vulës dhe veprime tjera të rregulluara me dispozitat ligjore , Kryetari i komunës me vendim emëron komisionin prej tre anëtarësh.

RUAJTJA E VULAVE

Neni 12.

12.1. Shërbyesi civil i cili përdor vulat është përgjegjës për autorësinë dhe vërtetësinë e akteve zyrtare , në të cilat vihet vula.

12.2. Përdoruesi i vulës është i detyruar të mbaj evidencë për vulat që i ka në përdorim.

12.3. Fillimi i përdorimit të vulës bëhet me vendim nga udhëheqësi i komunës.

12.4. Udhëheqësi i institucionit me shkrim autorizon personin përgjegjës që të përdor vulën , të mbaj evidencë të plotë dhe të saktë për përdorimin e vulës dhe të ruaj një kopje të dokumentit të vulosur.

12.5. Vula e komunës përdoret vetëm brenda selis të komunës , përjashtimisht edhe jashtë saj , por me leje të udhëheqësit.

Neni 13.

13.1. Kur vula humbet ose bëhet e pa përdorshme , menjëherë lajmërohet udhëheqësi i komunës dhe Ministria brenda 24.orëve.

13.2. Vula e humbur ose e papërdorshme , me vendim të udhëheqësit të komunës ajo shpallet e pavlefshme.

SANKCIONET KUNDËRVAJTË

Neni 14.

Për shkeljet e dispozitave të Ligjit dhe të kësaj Rregullore komuna dhe institucionet tjera komunale do të ndëshkohen me gjobë të cilat janë përcaktuar me Ligjin për vulat në institucionet e Republikës së Kosovës.

Neni 15.

Rregullorja hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit komunal në Dragash.

KRYESUESI I KUVENDIT KOMUNAL,

Lulzim Rifaj

01.Nr.06/81/3
Dt.29.05.2009